



REPUBLIKA E SHQIPERISË
MINISTRIA E FINANCEVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E THESARIT
DREJTORIA E KONTABILITETIT DHE RAPORTIMIT FINANCIAR

Tirane... 06.02.2009

Nr. 1376/1 Prot.

3

URDHËR

Nr. 12 datë 06.02.2009

PËR SHPALLJEN E NDRYSHIMEVE TË STANDARDIT NDËRKOMBËTAR TË KONTABILITETIT 39, DHE STANDARDIT NDËRKOMBËTAR TË RAPORTIMIT FINANCIAR 7, "RIKLASIFIKIMI I AKTIVEVE FINANCIARE", TË PËRKTHYER NË GJUHËN SHQIPE.

Në mbështetje të nenit 4, pika 3, të ligjit nr.9228, datë 29.04.2004 « Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare », të ndryshuar me Ligjin nr.9477 datë 09.02.2006, në vendimin nr.5 datë 26.12.2008 të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, dërguar me shkresën nr.145 datë 29.12.2008 dhe shkresën nr.16 datë 03.02.2009.

URDHËROJ

1. Shpalljen e ndryshimeve në Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit (SNK) 39, dhe në Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar 7, "Riklasifikimi i Aktiveve Financiare" të përkthyer në gjuhën shqipe, nën përgjegjësinë e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit pa ndryshuar nga teksti origjinal në gjuhën angleze, sipas materialeve përkatëse bashkëngjitur.
2. Ndryshimet në Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit (SNK) 39, dhe në Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar 7, "Riklasifikimi i Aktiveve Financiare" bëhen të detyrueshme për zbatim nga data efektive e kalimit e shprehur në Standard.
3. Ndryshimet në Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit (SNK) 39, dhe në Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar 7, "Riklasifikimi i Aktiveve Financiare" publikohen në faqen e internetit të Ministrisë së Financeve dhe të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit.
4. Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit të organizojë punën për botimin e ndryshimeve, në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga Marrveshja e lidhur për këtë qëllim, me Bordin e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (IASCF) në Londër.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

